

14 Sektori financiar dhe i patundshmërive,
atraktiv për investitorët

10 Prodhim për
Evropë

IBANK

Dhjetor 2018 | Nr. 17 - Gratis

**Mehmeti: Kamatat
në kredi mund
të bien edhe vitin tjetër**

FAQE 07

BANKAT, 210 MILIONË € BIZNESEVE PRODHUESE

Bankat komerciale në Kosovë e kanë rritur kreditimin për bizneset prodhuese, duke kontribuar kështu në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka bërë të ditur se 210 milionë euro ka arritur shuma e përgjithshme e kreditimit bankar vetëm për bizneset prodhuese, masë kjo që zvogëlon varësinë nga importet dhe njëkohësisht krijon vende të reja pune **FAQE 03**

**Përfitimet nga
zhvillimi i
agroindustrialisë**

FAQE 02



Përfitimet nga zhvillimi i agroindustrisë



EKREM GJOKAJ

Pjesëmarrja e sektorit të bujqësisë në Bruto Produktin Vendor (BPV) mbetet jashtëzakonisht e rëndësishme. Sektori i bujqësisë luan rol dominues edhe në punësim. Nga regjistrimi i bujqësisë i vitit 2014 llogaritet se në këtë sektor janë të punësuar 86,620 persona me orar të plotë, prej të cilëve rreth 50% janë anëtarë të familjes që angazhohen në fermë, rrjedhimisht, ndryshe nga viti 2016, në vitin 2017 kishte rritje për 4.2%.

Në kuadër të aktiviteteve të bizneseve bujqësore apo agroindustrisë në vitin 2017 qarkullim më të madh ka pasur në përpunimin e produkteve ushqimore, kjo vlerë e qarkullimit ka arritur në 227.4 milionë euro. Nga degët tjera të agroindustrisë, prodhimi i pijeve ka pasur qarkullim prej 95.7 milionë euro, i ndjekur nga prodhimi bimor dhe shtazor, gjuetia dhe shërbimet e lidhura me to, që në total kishin qarkullim prej 48 milionë euro. Me vlerë të përafërt të qarkullimit ishte edhe industria e drurit dhe produkteve të drurit, me qarkullim vjetor prej 35.1 milionë euro.

Gjatë viteve 2008-2016, në eksportin e përgjithshëm pjesëmarrja më e ulët ka qenë në vitin 2011 me 8.2%, ndërsa pjesëmarrje më e lartë u arrit në vitin 2017, me 16.2%. Në shkëmbimin tregtar të produkteve bujqësore, për vitet 2008-2017, vërehet se në vazhdimësi kemi një trend të lehtë të rritjes së eksportit. Rritje më e madhe e vlerës së eksportit të produkteve bujqësore ka qenë në vitin 2017, me 61.3 milionë euro, që është rritje e eksportit për 35.5% më shumë se sa në vitin 2016. Vlen të theksohet se vlera e eksportit në vendet e BE-së gjatë vitit 2017 ishte mbi 18.3 milionë euro, që në krahasim me vi-

tin paraprak del të jetë 53.4% më e lartë.

Bujqësia dhe industria tradicionalisht janë konsideruar si dy sektorë të ndarë, si nga karakteristikat e tyre ashtu edhe nga roli i tyre në rritjen ekonomike. Një ndër sektorët që mund të ndihmojë në nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik në vitet e ardhshme vlerësohet të jetë bujqësia dhe industrinë e lidhura me agro-përpunimin. Kështu, si rezultat i mbështetjes financiare dhe zbatimit të politikave adekuatë nga MBPZHR-ja, në vazhdimësi, kemi rritje të sipërfaqeve me kultura të ndryshme bujqësore, rrjedhimisht edhe rritje të prodhimit, si në sektorin e hortikulturës, ashtu edhe në atë të kulturave lavërtare. Krahasuar me vitin paraprak, vetëm në vitin e fundit kemi rritje të sipërfaqeve me perime për rreth 2.1%, apo 169 hektarë, si dhe ngritje të serrave të reja për rreth 20% në raport me vitin paraprak. Edhe sipërfaqet me pemishte të reja kanë pasur një ngritje prej 13.6%, me rreth 754 hektarë pemishte të reja.

Edhe sektori i vreshtave është rritur me 2.8% krahasuar me vitin paraprak. Nëse e krahasojmë numrin e përfituesve nga grantet investive, këtë vit kemi rritjen e numrit të përfituesve për rreth 70% krahasuar me vitin paraprak, ky njëherësh mund të llogaritet si viti më i suksesshëm në zbatimin e programit për bujqësi dhe zhvillim rural, si në numrin e përfituesve, si në kualitetin e projekteve dhe përzgjedhjen e tyre. Shprehur ndryshe, këtë vit janë mbështetur të gjitha kategoritë e fermave, duke filluar nga fermat e vogla, fermat fillestare, fermat e mesme të orientuara nga tregu, fermat e mëdha dhe kompanitë përpunuese. Në total janë mbështetur mbi 20 kompani agro-përpunuese në sektorin e pemëve dhe perimeve, qumështit, mishit dhe verës.

Po ashtu, këtë vit është mbështetur edhe ndërtimi i depove të ruajtjes së produkteve, si në nivel të fermave të veçanta, ashtu edhe në nivel regjionesh si asnjë herë më parë.

Marrë në përgjithësi, trendi i zhvillimit të sektorit të bujqësisë është pozitiv. Në këtë sektor kemi lëvizje të ngadaltë por të sigurt të ndryshimeve strukturore, kjo pasi që kemi ulje të sipërfaqeve me drithëra për rreth 10-13% dhe shtim të sipërfaqeve në sektorin e hortikulturës për 13-20%, kultura këto që kanë avantazhe krahasuese dhe potencial për eksport.

Ashtu si vendet tjera edhe në Kosovë zhvillimit të agriondustrisë i është dhënë vëmendje e veçantë përmes politikave programore të zhvillimit, duke e

konsideruar si një sektor të industrisë që gjeneron vende pune, ku një numër i madh njerëzish varen drejtpërdrejt ose në mënyrë indirekte për mirëqenien e tyre. Kjo vlen sidomos për vendin tonë ku në degët tjera të industrisë duhet bëhen shumë investime për revitalizimin e tyre.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural përmes subvencioneve dhe granteve ka për qëllim që të rris kualitetin e prodhimeve bujqësore, rritjen e prodhimit dhe tregut, ta reduktoj importin nga i cili ndikohen edhe çmimet e prodhimeve vendore. Duke investuar në zhvillimin e agroindustrisë nuk rriten vetëm të ardhurat e fermerëve, por gjithashtu krijohen mundësi të reja punësimi në zonat rurale. Për këtë arsye janë bërë avancime të shumta në teknologjinë e industrisë agro-ushqimore, meqenëse teknologjitë e vjetra nuk kanë mundur të përdoren për shkak të shkatërrimit të tyre gjatë luftës por edhe për arsye të vjetërimit të tyre.

Bazuar në të dhënat e ASK-së shohim se, duke filluar nga viti 2012 deri në vitin 2014 mesatarja e pjesëmarrjes së aktiviteteve bujqësore të regjistruara në regjistrin e biznesit ndaj aktiviteteve tjera ishte 7.6%.

Duke filluar nga viti 2015 kemi një rritje prej 9.6%, e pasuar me rritje të pjesëmarrjes në 10.4% në vitin 2016. Ndërsa në vitin 2017 kjo pjesëmarrje ishte 8.9%, një rritje e tillë i atribuohet mbështetjes financiare që po ofrohet nga MBPZHR përmes zbatimit të kësaj mase strukturore. Sa i përket rritjes së numrit të aktiviteteve në bujqësi, rritje më e hovshme ka qenë në vitin 2015, me 945 aktivitete bujqësore apo 40.2% më shumë se sa në vitin 2014, duke vazhduar me rritje në vitin 2016 me 1,090 aktivitete, apo 15.3% më tepër se sa në vitin 2015. Ndërsa në vitin 2017 kishte 268 biznese më pak në krahasim me vitin 2016 apo rënie prej 24.6%. Bazuar në të dhënat që merren nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, agrobizneset kanë shënuar rritje nga viti në vit. Nga viti 2011-2016, mesatarisht për këto vite qarkullimi i përgjithshëm ka qenë 307 mil.€, duke vazhduar me rritje prej 19.9% në vitin 2017, krahasuar me mesataren e gjashtë viteve (2011-2016).

(AUTORI ËSHTË U.D I KRYESHEFIT TË AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË)



Bankat, 210 milionë euro bizneseve prodhuese

Bankat komerciale në Kosovë e kanë rritur kreditimin për bizneset prodhuese, duke kontribuar kështu në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka bërë të ditur se 210 milionë euro ka arritur shuma e përgjithshme e kreditimit bankar vetëm për bizneset prodhuese, masë kjo që zvogëlon varësinë nga importet dhe njëkohësisht krijon vende të reja pune

Sektori bankar vazhdon të mbetet njëri ndër kontribuuesit kryesor në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Kosovës. Kështu ka theksuar guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) Fehmi Mehmeti. Sipas tij rreth 75 për qind e kredive janë të drejtuara tek bizneset. "Sektori bankar vazhdon të jetë ndër kontribuuesit kryesorë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Kosovës. Mbështetje për këtë konstatim është fakti se rreth

210
milionë euro ka arritur
kreditimi bankar për sektorin
prodhues në Kosovë deri në
shtator të vitit 2018

75% e kredite të sektorit bankar ndaj ekonomisë vendore janë të drejtuara tek bizneset", ka theksuar Mehmeti. Shuma e përgjithshme e kredive të aprovuara nga sektori bankar i Kosovës arrinë në rreth 2.7 miliardë euro, ku rritja vjetore e kredive në tetor të këtij viti ka kaluar shumë prej 280 milionë euro, apo 11.6%, përderisa në periudhën e njëjtë të vitit 2017 rritja vjetore e kredive ka qenë 234.4 milionë euro, apo 10.7%. 'Kjo përkrahje e



1.703 MILIARDË€

ËSHTË SHUMA E PËRGJITHSHME E KREDIVE BANKARE PËR NDËRMARRJET.

973.2 MILIONË €

ËSHTË SHUMA E PËRGJITHSHME E KREDIVE PËR EKONOMITË FAMILJARE

11.6%

KANË SHËNUAR RITJE VJETORE KREDITË PËR NDËRMARRJET GJATË VITIT 2018

11.3%

JANË RRIUR KREDITË PËR EKONOMITË FAMILJARE GJATË KËTIJ VITI.



theksuar financiare është tregues për ndikimin e sektorit bankar në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në Kosovë”, ka potencuar Mehmeti.


QINDRA MILIONA EURO KREDI PËR SEKTORIN PRODHUES

Bankat komerciale në vazhdimësi i kanë mbështetur bizneset të cilat kanë paraqitur plane të mira investive në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, duke i kushtuar një vëmendje edhe kreditimit të sektorit të prodhimit. Kreditimi bankar për sektorin prodhues në vend ka arritur në 210 milionë euro.

“Bankat në vazhdimësi janë duke i përkrahur bizneset të cilat po investojnë në sektorët e prodhimit. Kjo përkrahje po vazhdon të ketë rritje të theksuar të kreditimit, e cila vërehet që nga shtatori i viti 2016 që ishte 166.1 milion euro, në shtator të vitit 2018 arrin shumë prej 209.9 milion euro”, ka bërë të ditur guvernatori i BQK-së.

Ai ka shtuar se vitet e fundit vërehet një ngritje e vetëdijesimit të bizneseve, duke prezantuar te bankat plane investive ambicioze në prodhim. “Rritja e kreditimit në sektorin e prodhimit, me anë të përkrahjes së bizneseve ndikon direkt edhe në rritjen e prodhimit vendor dhe zvogëlimin e importit”.

166.1
MILIONË EURO KA QENË SHUMA E PËRGJITHSHME E KREDIVE PËR SEKTORIN PRODHUES NË VEND DERI NË SHTATOR 2016



Cakolli: Sistemi bankar ndër promotorët kryesor të zhvillimit të sektorit privat

Bujar Cakolli, zëvendësministër i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Qeverinë e Kosovës, ka theksuar se sistemi i kreditimit përmes bankave komerciale paraqet një prej shtyllave kryesore të financimit të ekonomisë së vendit. “Bankat Komerciale në Republikën e Kosovës kanë mbështetur dhe vazhdojnë t’i mbështesin bizneset në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Sipas të dhënave nga Banka Qendrore e Kosovës pjesa kryesore e kredive të bankave gjatë muajve të fundit është drejtuar kah bizneset, që është një tregues i qartë i përkrahjes së bizneseve vendore nga sektori bankar në Kosovë”, ka pohuar Cakolli.

Zëvendësministri i Ndërmarrësisë ka theksuar se sa i përket normave të interesit në kredi, të cilat më herët kanë qenë shumë më të larta, kohën e fundit ka pasur zhvillime shumë pozitive që kanë reflektuar në uljen e dukshme të tyre. “Mendoj se në të ardhmen roli i sistemit bankar në përkrahjen e bizneseve do të jetë edhe më i madh, kur kemi parasysh se në vazhdimësi kemi ulje të normave të interesit, por edhe konkurrenca gjithnjë në rritje në këtë sektor është njëri ndër faktorët kryesor që ndikon në zhvillimin e sektorit privat”, ka theksuar Cakolli.

‘Bankat në vazhdimësi janë duke i përkrahur bizneset të cilat po investojnë në sektorët e prodhimit. Kjo përkrahje po vazhdon të ketë rritje të theksuar të kreditimit, e cila vërehet që nga shtatori i viti 2016 që ishte 166.1 milion euro, në shtator të vitit 2018 arrin shumën prej 209.9 milion euro’, kështu ka theksuar guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) Fehmi Mehmeti

7.4%

është norma mesatare e efektive e interesit në kreditë për ekonomitë familjare



6.6%

është norma mesatare e interesit në kreditë për ndërmarrjet



6.1%

është norma mesatare e interesit në kreditë hipotekare



KONTRIBUTI NË RRRITJEN EKONOMIKE

Brenda një periudhe të shkurtër Kosova ka arritur që ta ndërtojë një sistem financiar dhe bankar të mirëfilltë, i cili vazhdon të kontribuojë në rritjen ekonomike të vendit. Por, qëllimi i shtetit më të ri në Evropë duhet të jetë rritja e mirëqenies socio-ekonomike të qytetarëve dhe luftimi i varfërisë. Kështu ka theksuar drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija. Edhe Ibish Mazreku, prorektor për marrëdhënie ndërkombëtare dhe ngritje të cilësisë në Universitetin Publik “Haxhi Zeka” në Pejë, thotë se në bazë të të dhënave dhe prirjeve zhvillimore, sistemi bankar në Kosovë është duke dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm në sigurimin e burimeve financiare për zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme që operojnë në vendin tonë. Sipas tij, bazuar në raporte zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se rritja e kreditimit për ndërmarrje për këtë vit është dyshifrore.

ai shprehet se për t’i zhvilluar NVM-të shteti duhet të ndajë fonde të caktuara të cilat më pastaj përmes bankave do të futen në funksion

të zhvillimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, kur dihet se në to punësohet një numër i madh i punëtorëve.

EFEKTET POZITIVE NGA GARANTIMI I KREDIVE

Besnik Berisha, drejtor menaxhues i Fondit për Garanci Kreditore, bën të ditur se institucioni që e drejton është i pavarur por u lëshon garanci institucioneve financiare për mbulimin e rrezikut për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të Mesme. Sipas tij, deri në fund të tetorit 2018, shuma totale e kredive të miratuara nga bankat dhe që janë dorëzuar nën mbulimin e garancisë ka arritur në 75.3 milionë euro të shpërndara në mbi 1,928 kredi, ndërsa pjesa e garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ka arritur në 36 milion euro. “Shuma e përgjithshme e garancive të lëshuara gjerë më tani është 36 milion ndërsa rritja vjetore e vitit 2018 bazuar në principalin e portfolios se garancioneve është 124%”, kanë raportuar mediat.

Ai ka bërë të ditur se garancitë kreditore lëshohen për NMVM-të në pronësi private të cilat kanë regjistrimin e biznesit dhe numrat fiskalë si dhe

të cilat janë njëqind për qind (100%) në pronësi të qytetarëve privatë ose banorëve të përhershëm të Kosovës.

Fondi Kosovarë për Garanci Kreditore (FKGK) përmes garantimit të portfolit kreditor të institucioneve financiare, synon të përkrahë sektorin privat në Kosovë, duke zgjeruar qasjen në financa për NMVM-të të cilat nuk kanë kolateral të mjaftueshëm, duke mundësuar kështu edhe krijimin e vendeve të punës, rritjen e prodhimit vendor, përmirësimin e bilancit tregtar dhe avancimin e mundësive për sektorët ekonomikë më pak të shërbyer.

Për më tepër, si rrjedhojë e kësaj, NMVM-të në saje të përkrahjes financiare do të mund të realizojnë investime të reja, investime innovative, duke rritur kështu konkurrueshmëri në tregun lokal, regjional dhe ndërkombëtar, etj. Sipas Berishës, investimet e bëra me këto kredi premtajnë efekte pozitive në përgjithësi. “Sipas parashikimit të kredimarrësve nga kreditë e lëshuara deri në fund të tetorit 2018 do të krijohen 2,681 vende të reja pune si dhe 79.8 milion euro rritje të qarkullimit mbi bazën e tanishme të qarkullimit të NMVM-ve përkatëse”, ka sqaruar ai.



MEHMETI: KAMATAT NË KREDI MUND TË BIEN EDHE VITIN TJETËR

Normat e interesit në kreditë bankare kanë shënuar rënie drastike nga viti 2008 e këndej, që kur Kosova shpalli pavarësinë. Por, guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, vlerëson se ka hapësirë që kamatat në kredi të zvogëlohen edhe vitin tjetër

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, thotë se gjatë vitit 2018 bankat komerciale në vend kanë performuar me rezultate financiare pozitive, ku për herë të parë në historinë e këtij sektori të gjitha bankat kanë arritur të shpërndajnë dividendë, përveç degëve të bankave të huaja. “Këtu përfshihen edhe bankat vendore që tashmë paraqesin një storie suksesi”, thotë guvernatori Mehmeti, duke shtuar se gjatë periudhës janar-tetor 2018 bankat kanë realizuar fitim të pastër në vlerë prej 70.2 milionë euro.

I pari i BQK-së ka bërë të ditur se kreditë në sektorin bankar kanë arritur në rreth 2.7

miliardë euro, përderisa depozitat mbi 3.250 miliardë euro.

Ndonëse normat e interesit në kredi kanë shënuar rënie nga viti në vit, Mehmeti shprehet i bindur se gjatë vitit të ardhshëm të njejtat do të zvogëlohen edhe më tej.

“Bazuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së kredive, si dhe planifikimet e bankave për të vazhduar me rritje të kredive, vlerësojmë që normat e interesit në kredi do të kenë hapësirë të zvogëlohen edhe në vitin e ardhshëm. Në këtë kontekst duhet të kemi parasysh faktin që edhe normat e interesit në depozita janë duke shënuar rritje duke arritur në 1.37% në shtator 2018, që paraqet rritje të

theksuar në krahasim me 0.95% në shtator 2017”, ka pohuar Mehmeti.

Guvernatori i BQK-së ka folur edhe për trendet globale të digjitalizimit, të cilat po i përcjellë edhe sektori bankar i Kosovës, duke investuar në platforma elektronike të bankingut, me anë të ofrimit të shërbimeve për klientët e vet 24/7.

Ai thotë se digjitalizimi i shërbimeve nuk e ka zvogëluar numrin e puntorëve në sektorin bankar, pasi që, sipas statistikave të Bankës Qendrore, numri i të punësuarëve është i njëjtë në katër vitet e fundit, ku në vitin 2015 kanë qenë 3375 të punësuar, ndërsa aktualisht janë 3374 punëtorë.

**MBI 3.2 MILIARDË EURO DEPOZITA,
RRETH 2.7 MILIARDË EURO KREDI****Z. Guvernatori jemi në përfundim të vitit 2018, si e vlerësoni performancën e sektorit bankar gjatë këtij viti?**

Mehmeti: Performanca e sektorit bankar gjatë vitit 2018 ishte pozitive duke qenë lart mbi treguesit e caktuar rregullativ, ku siç kemi thënë shumë herë deri në tani vazhdon të jetë stabil, me likuiditet të mjaftueshëm dhe mirë të kapitalizuar. Asetet e sektorit bankar në tetor 2018 gjithsej ishin rreth 3.877 miliardë euro, ku kreditë paraqesin vlerën prej 2.696 miliardë euro dhe depozitat shënojnë vlerën prej 3.251 miliardë euro. Shikuar në kontekst vjetor, si kreditë e po ashtu edhe depozitat, shënuan rritje vjetore prej 11.6%, respektivisht 6.4%. Në kuadër të strukturës së asetëve dominojnë kreditë me pjesëmarrje prej 69.5%, ndërsa depozitat në kuadër të detyrimeve me pjesëmarrje prej 95.7%.

Sektorit bankar ka vazhduar të performojë me rezultate financiare pozitive edhe në këtë vit, duke realizuar fitim në vlerë prej 70.2 milionë euro deri në muajin tetor 2018. Me këtë rast duhet theksuar që gjatë vitit 2018, për herë të parë në histori të sektorit bankar në Kosovë, të gjitha bankat kanë arritur të shpërndajnë dividendë (përveç atyre që janë të licencuara si degë të bankave të jashtme). Këtu përfshihen edhe bankat vendore që tashmë paraqesin një storie suksesi.

Trendi i përmirësimit të cilësisë së kredive në vitin 2017 ka vazhduar edhe përgjatë vitit 2018. Treguesi i kredive joperformuese në muajin tetor 2018 ka rënë në 2.7%, nga 3.1% sa ishte në muajin dhjetor 2017. Ky tregues në tetor 2017 evidentohet 3.6%. Rezervat për humbjet nga kreditë mbulojnë kreditë joperformuese në nivel të kënaqshëm prej 154.9%. Krahasuar me shtetet e rajonit Kosova vazhdon të ketë nivelin më të ulët të kredive joperformuese.

KREDITË JOPERFORMUESE 2.7%**Viti 2018 është karakterizuar me norma më të ulëta të interesit në kredi, si dhe zvogëlim të përqindjes së kredive joperformuese. A priten rënie të kamatave në kredi edhe në vitin 2019?**

Mehmeti: Cilësia e kredive në sektorin bankar ka shënuar përmirësim të vazhduar përgjatë vitit 2018. Treguesi i kredive joperformuese në muajin tetor 2018 shënon normë prej 2.7%, i cili në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar evidentohet 3.1%. Ngjashëm, edhe normat e interesit në kredi kanë vijuar me trendin e rënies. Norma mesatare efektive e interesit për kreditë e reja në muajin shtator 2018 përlllogaritej 6.99%, ose nëse e marrim mesataren e periudhës janar – shtator 2018 ajo ishte 6.76% (6.85% krahasuar me horizontin kohor të njëjtë me vitin e kaluar).

Bazuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së kredive, si dhe planifikimet e bankave për të vazhduar me rritje të kredive, vlerësojmë që normat e interesit në kredi do të kenë hapësirë të zvogëlohen edhe në vitin e ardhshëm. Në këtë kontekst duhet të kemi parasysh po ashtu faktin që edhe normat e interesit në depozita janë duke shënuar rritje duke arritur në 1.37% në shtator 2018, që paraqet rritje të theksuar në krahasim me 0.95% në shtator 2017.

Dekada e përgjysmimit të kamatave në kredi



Performanca e sektorit bankar gjatë vitit 2018 ishte pozitive duke qenë lart mbi treguesit e caktuar rregullativ, ku siç kemi thënë shumë herë deri në tani vazhdon të jetë stabil, me likuiditet të mjaftueshëm dhe mirë të kapitalizuar. Asetet e sektorit bankar në tetor 2018 gjithsej ishin rreth 3.877 miliardë euro, ku kreditë paraqesin vlerën prej 2.696 miliardë euro dhe depozitat shënojnë vlerën prej 3.251 miliardë euro. Shikuar në kontekst vjetor, si kreditë e po ashtu edhe depozitat, shënuan rritje vjetore prej 11.6%, respektivisht 6.4%, tha guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës(BQK) Fehmi Mehmeti

Nëse e bëjmë një krahasim me vitin 2008, kur Kosova e ka shpallur pavarësinë, sa kanë rënë normat e interesit në kredi përgjatë dekadës së parë të pavarësisë?

Mehmeti: Krahasuar me vitin 2008 kur edhe është shpallur pavarësia e Kosovës, në përgjithësi ka zhvillime shumë pozitive në sektorin bankar në Kosovë e në veçanti tek normat e kamatës. Para se të cekim normat e kamatës, më lejoni të theksoj që edhe qasja jonë si rregullator dhe mbikëqyrës të sektorit financiar është shumë më proaktive dhe më kërkuese. Janë zhvilluar manuale dhe standarde të tjera mbikëqyrëse që mundësojnë fokusimin tek rreziqet që ndodhin në sektorin bankar në Kosovë. Ndër të tjera, kjo ka bërë që sot të flasim për sektor bankar shumë më konkurrues, konkurrencë e cila është shfaqur edhe në uljen substanciale të normës së interesit në kredi. Për më shumë, gjatë vitit 2008 norma mesatare e interesit në kredi të reja shënonte nivel shumë të lartë prej 14.73%, ku niveli mbi 14% normë të interesit ishte i aplikuar për vite të tëra dhe që ishte shumë më i lartë se sa vendet e rajonit.

Falë zhvillimeve që janë cekur më lart, sot flasim për norma të interesit të krahasueshme me vendet e rajonit e në pika të caktuara (kreditë hipotekare) ndoshta edhe më të ulëta. Siç është cekur më lart, niveli prej 6.35% paraqet mesataren e periudhës së caktuara, përderisa për produkte të caktuara (kreditë hipotekare) ato sillen në nivel prej rreth 5.24%.

Nëse statistikat dëshmojnë për një ulje drastike të kamatave në kredi për dhjetë vite, çka ka ndodhur me normat e interesit në depozita, si kanë lëvizur përgjatë kësaj periudhe kohore?

Mehmeti: Në vitin 2008 norma e interesit në depozita të reja shënonte normë prej 4.21%, në periudhën kur ato në kredi ishin mbi 14% e ku diferenca e normave të interesit në depozita dhe kredi ishte mbi 10 pikë përqindje. Sot bankat operojnë me diferenca shumë më të ulëta që vjen si pasojë e rritjes së vazhdueshme të konkurrencës, kjo e shtytur edhe nga infrastruktura legjislative dhe mbikëqyrja më e përafërt.

Në shtator 2018 norma në depozita (siç është cekur më lart) është 1.37%, ndërsa në afatizime më të gjata se një vit ka norma të interesit me nivel mbi 3%. Ajo që duhet cekur me këtë rast dhe që është diçka shumë pozitive është se përkundër faktit që bankat në Evropë në të shumtën e rasteve aplikojnë norma negative të interesit, kjo asnjëherë nuk ka ndodhur në Kosovë, përkundrazi, depozitarët janë joshur që kursimet e lira t'i afatizojmë me norma atraktive të interesit.

Sa po kotribuon sistemi bankar në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Kosovës?

Mehmeti: Sektorit bankar vazhdon të jetë ndër kontribuuesit kryesorë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Kosovës. Faktori kryesor që ta themi këtë janë kreditë e sektorit bankar ndaj ekonomisë vendore, ku rreth 75% janë të drejtuara tek bizneset. Kreditë kanë shënuar trend të rritjes ndër vite, e sidomos dy – tri vitet e fundit (që nga viti 2016) duke shënuar nivele dy shifrore të rritjes së kredive. Kreditë e përgjithshme në tetor 2018 kanë shënuar rritje vjetore me 280.1 milion euro ose 11.6%, përderisa rritja vjetore e gjithsej kredive në tetor të vitit 2017 me vitin paraprak

KREDITIMI I SEKTORËVE

NDËRTIMTARIA



6.1%

TREGTIA



31.9%

PRODHIMTARIA



8.2%

DIXHITALIZIMI I SEKTORIT BANKAR PA EFEKT
NEGATIV NË PUNËSIME



2015
3375
PUNËTORË



2016
3375
PUNËTORË



2017
3319
PUNËTORË



2018
3374
PUNËTORË

Mehmeti: Norma e interesit në kreditë e reja hipotekare në muajin shtator 2018 është 6.11%, krahasuar me 5.88% sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Nëse ndalemi në komponentë të caktuar brenda kredive hipotekare, shohim se kreditë hipotekare me maturitet mbi 10 vjeçar shënojnë normën prej 5.11% në horizontin kohor janar – shtator 2018, krahasuar me 5.18% të vitit të kaluar.



ka qenë 234.4 milion euro ose 10.7%. Kjo për përkrahje e theksuar financiare po që tregon ndikimin e sektorit bankar në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në Kosovë.

Po e bëjmë pyetjen, nëse bankat janë duke u rritur shumë shpejtë dhe a ka hapësirë akoma për rritje, përgjigja sigurisht se është pozitive. Indikatorit që ne përdorim për të matur shpejtësinë e rritjes është ai i ndërmjetësimit financiar në raportin me prodhimin e brendshëm bruto në Kosovë. Në këtë kontekst, ky tregues në qershor 2018 u rrit në 39.8% krahasuar me 33.8% sa ishte në vitin 2015, duke shënuar kështu rritje graduale por të qëndrueshme. Kjo për dallim nga vendet e rajonit që në të shumtën kanë nivelin e njëjtë ose rënie për shtete të caktuara. Me këtë rast duhet cekur që mesatarja e vendeve të rajonit në kontekst të shkallës së ndërmjetësimit financiar është rreth 55%.

Përpos rritjes së kreditimit për ekonomitë familjare, rritje të kreditimit bankar është shënuar edhe për bizneset. Në cilët sektorë të ekonomisë janë të përqëndruara kryesisht kreditë bankare?

Mehmeti: Aktiviteti kreditues vazhdon të jetë i orientuar drejt kreditimit të sektorit të tregtisë, pjesëmarrja e të cilave në gjithësej portofolin kreditor të sektorit bankar eviden-

tohet 31.9% në shtator 2018 nga 31.6% sa ishte në dhjetor të vitit 2017. Kreditë individuale-konsumuese kanë shënuar trend të njëjtë, pesha e të cilave në gjithësej kreditë shënon rreth 36 % në tetor 2018. Gjithashtu, rritje ka shënuar edhe pjesëmarrja e kredive të dhëna për prodhimtari në 8.2% nga 8 %, atyre për ndërtimtari në 6.1% nga 5.5%, si dhe kredive për patundshmëri në 0.5% nga 1.3%.

Sa po përkrahen bizneset prodhuese nga bankat komerciale nëpërmjet kredive, në mënyrë që të ndikohet në rritjen e prodhimit vendor dhe zvogëlimin e importit?

Mehmeti: Bankat komerciale gjatë viteve kanë vazhduar t'i mbështesin bizneset të cilat kanë paraqitur plane investive të mira në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, duke i kushtuar një vëmendje edhe kreditimit të sektorit të prodhimit.

Bankat në vazhdimësi janë duke i përkrahur bizneset të cilat po investojnë në sektorët e prodhimit, prirje e cila po vazhdon të ketë një trend me rritje të theksuar të kreditimit, e cila rritje vërehet që nga shtator 2016 që ishte 166.1 milion euro, në shtator 2018 arin shumën prej 209.9 milion euro. Vitet e fundit vërehet një ngritje e vetëdijesimit të bizneseve, me anë të prezantimit tek bankat të planeve investive ambicioze në prodhim.

Rritja e kreditimit në sektorin e prodhimit, me anë të përkrahjes së bizneseve ndikon direkt edhe në rritjen e prodhimit vendor dhe zvogëlimin e importit.


Normat e interesit në kredi janë më të ulëta për kreditë hipotekare. Sa janë kamatat mesatare në kreditë hipotekare, sa është vlera e përgjithshme e kredive hipotekare në Kosovë, si dhe sa është shuma e përgjithshme e pronave që janë në hipotekë?

Mehmeti: Norma e interesit në kreditë e reja hipotekare në muajin shtator 2018 është 6.11%, krahasuar me 5.88% sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Nëse ndalemi në komponentë të caktuar brenda kredive hipotekare, shohim se kreditë hipotekare me maturitet mbi 10 vjeçar shënojnë normën prej 5.11% në horizontin kohor janar – shtator 2018, krahasuar me 5.18% të vitit të kaluar.

Trendin e rritjes së gjithësej kredive në sektorin bankar të Kosovës e kanë ndjekur edhe kreditë hipotekare. Në muajin shtator 2018 kreditë hipotekare shënojnë nivel prej rreth 370.0 milion euro, të cilat kanë shënuar rritje vjetore me 45.0 milion euro ose 13.8% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

DEPOZITAT E SIGURTA

Edhe depozitat e klientëve në banka kanë ar-



3.251 MILIARDË €

ka arritur shuma e përgjithshme e depozitave në sektorin bankar të Kosovës.

2.696 MILIARDË €

ka arritur shuma e kredive në sektorin bankar të Kosovës.



70.2 MILIONË €

ka arritur fitimi i pastër i bankave kosovare gjatë periudhës janar-tetor 2018.

ritur rekordin prej rreth 3.2 miliardë euro, mjete këto shumë më të mëdha se buxheti vjetor i Kosovës. Sa janë të sigurt depozitat e klientëve në bankat komerciale?

Mehmeti: Depozitat kanë vazhduar të jenë burim kryesor i financimit për bankat e sektorit bankar të Kosovës, të cilat kanë shënuar rritje të vazhdueshme edhe në vitin 2018. Bankat e sektorit janë shumë stabile dhe posedojnë volum të mjaftueshëm të mjeteve likuide për tu mbrojtur nga rreziku i likuiditetit. Ato evidentojnë norma më të larta të treguesve kryesorë të likuiditetit krahasuar me normat e kërkuara rregulative. Përveç kësaj, bankat janë anëtare në Fondin për Sigurimin e Depozitave, ku çdo klientit në çdo bankë i sigurohet shuma deri në 5.0 mijë euro. Pra, marrë në përgjithësi, depozitat e klientëve janë

të sigurt, ku bankat në baza të rregullta periodike ekzaminohen nga BQK-ja, trendet janë stabile, si dhe nuk parashikojmë ndonjë zhvillim jo të zakonshëm. Me këtë rast duhet cekur që bankave çdo vit iu kërkohet që të dorëzojnë në BQK projeksionet financiare në bazë të të cilave përcillet edhe zhvillimi i tyre përgjatë vitit.

Bankat në Kosovë tashmë kanë digjitalizuar shumë shërbime, duke përcjellë kështu trendet globale të digjitalizimit në këtë sektor. Por, a ka ndikuar digjitalizimi në zvogëlimin e numrit të punëtorëve në sektorin bankar?

Mehmeti: Bankat komerciale gjatë viteve të fundit kanë vazhduar të orientohen në zhvillimin e kanaleve elektronike të komunikimit i cili paraqet një trend botëror të orientimit të shërbimeve të banking-

ut. Sektori bankar në Kosovë është duke përcjellë trendet globale të dixhitalizimit, duke investuar në platforma elektronike të bankingut, me anë të ofrimit të shërbime për klientët e vet 24/7. Investimet e bankave në kanalet elektronike të komunikimit si rrjedhojë e strategjive të bankave kanë reflektuar edhe në numrin e punëtorëve.

Megjithatë, gjatë viteve vërehet një trend stabil i numrit të punëtorëve në sektorin bankar, e cila ka rezultuar me anë të lëvizjeve së punëtorëve në kuadër të sektorit bankar, e që mund të shihet nëse krahasohet: dhjetor 2014 prej 3,507 punëtorë, dhjetor 2015 prej 3,375 punëtorw, dhjetor 2016 prej 3,375 punëtorw; dhjetor 2017 prej 3,319 punëtorw dhe shtator 2018 prej 3,374 punëtorw në sektorin bankar.



Prodhim për Evropë

Kompania kosovare “Scampa”, e cila merret me prodhimin e qeseve të plastikës, falë investimeve prej 2 milionë euro në një fabrikë të re, po bëhet gati që në një të ardhme të afërt t’ia nis një “mini revolucioni” në tregun kosovar, ku prodhimin e qeseve ta bëjë nga patatja e jo nga plastika. Prodhimet do t’i shes në Belgjikë

Kujtim Gjevori, pronar i kompanisë “Scampa” e cila me prodhimin e qeseve të plastikës e furnizon konsiderueshëm tregun vendor dhe njëkohësisht një sasi më të vogël të prodhimin e eksporton edhe në Evropë, po bëhet gati që bashkë me një partner belg ta ndërtojë një fabrikë të re, prodhimet e së cilës do t’i shes në Belgjikë. Kompania “Scampa” prodhimin e qeseve të plastike e bën brenda Parkut Industrial në Drenas, ku janë të vendosura disa biznese.

Investimet fillestare në këtë fabrikë parashihet të arrijnë në 2 milionë euro, prej të cilave 1.2 milionë euro janë kredi e siguruar nga bankat komerciale në Kosovë, derisa pjesa tjetër e financimit, do të bëhet nga partneri belg, ka sqaruar Gjevori. Sipas tij, të gjitha investimet në fabrikës do të bëhen sipas standardeve ndërkombëtare, ku do të bëhet edhe riciklimi i prodhimeve të mbetura. “Krejt çka mbetet në fabrikë riciklohet dhe përdoret për produkte tjera. Makina e riciklimit është përmes sistemit të mbyllur me ujë, ku as ujë na kanalizim nuk gjuhet. Jemi duke e zhvilluar kompaninë me parametra të kompanive evropiane”, tregon ai.

Ai tregon se çdo herë zgjerimin e biznesit e ka bërë nëpërmjet financimit bankar dhe pranon se normat e interesit në kredi kanë rënë dukshëm, krahasuar me vitin 2007 kur kishte vendosur ta

5%

është norma e interesit në kredi të cilën e ka marrë ‘Scampa’, derisa më herët e njëjta arrinte në **20%**.

zhvillojë biznesin për prodhimin e qeseve plastike.

Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka bërë të ditur se bankat komerciale të Kosovës në përkrahje të bizneseve prodhuese kanë aprovuar rreth 210 milionë euro kredi.

“MINI REVOLUCIONI” KOSOVAR, QESE NGA PATATJA

Me investimet 2 milionëshe kompania ‘Scampa’ planifikon t’ia nis një mini revolucioni në tregun kosovar, ku në një të ardhme të afërt planifikon që plastika mos të jetë lëndë e parë për prodhimin e qeseve, por patatja. “Brenda tre viteve do të prodhojmë qese nga patatja. Në fillim do të eksportojmë në Evropë, pasi që e kemi gjetur një blerës poten-

cial në Belgjikë, por për arsye të koston më të shtrënjtë të prodhimit, minimum tre herë më shumë se sa kostoja aktuale, tregun i Kosovës ende nuk është i gatshëm. Edhe Kosova me ligje të integruara nga BE-ja do të detyrohet ta ndërrojë dhe të prodhojë qese në këtë formë. Tashmë në Itali prodhohen qese nga patatja”, ka thënë në fund biznesmeni Gjevori.

VETËM PRODHIMI VENDOR E NDALË IMPORTIN

Rritja e vazhduese e kapaciteteve prodhuese, përveç se e ka rritur dukshëm numrin e të punësuarve në fabrikë, ka pasur edhe efekt direkt në rënien drastike të importit të qeseve nga vendet e rajonit, por edhe më larg. Ai tregon se falë punës dhe angazhimit të madh sot është lider në fushën e prodhimit të qeseve dhe të thasëve të mbeturinave. “Unë së bashku me të tjerët e kemi ndaluar importin e qeseve, pasi që 90 % tregut mbulohet me prodhim vendor, derisa pjesa tjetër mbulohet me qese të prodhuara në shtete tjera e që importohen në vendin tonë. Kohet e fundit kemi filluar të eksportojmë në shtete të ndryshme evropiane, por eksporti është nën 10 % të prodhimit mujor”, tha ai.

NGA KREDIA NË KREDI

Gjevori pohon se Investimet në zhvillimin



e biznesit vazhdimisht i ka bërë me ndihmën e bankave komerciale në Kosovë. Ai tregon se në vitin 2007 kur kishte vendosur ta zgjeronte biznesin e tij duke hapur një fabrike për prodhimin e qeseve, “nga banka i kishte mora 300 mijë euro kredi dhe i bleva disa makina dhe një tokë në Lipjan. Në fillim jemi ballafaquar me sfida të shumta. Kur e kam nisur punën në atë kohë i kam pasur 4-5 punëtorë, derisa tash numrin e punëtorëve e kemi dhjetëfishuar”, shprehet Gjevori, duke shtuar se asokohe nuk kanë mundur të prodhojnë aq sa kanë pasur kërkesë për produktet e tyre. Tutje ai shprehet: “Kështu e vazhduam zgjerim. Shumë shpejt, ende pa përfunduar kredia, atë e mbyllëm dhe e morëm një tjetër prej 450 mijë euro, pastaj vazhduam me kreditë e reja prej 600 mijë euro, 800 mijë euro etj, dhe se së fundi kemi marrë një kredi prej 1,2 milionë euro për zhvillim të biznesit. Sikur të mos të kishin qenë kreditë bankare unë nuk do të kisha pasur mundësi të jem këtu. E mira është se unë prapë përmes kredive po hap një fabrikë të re me një partner belg”, thotë ai.

NUK E KA SHIKUAR ASNJËHERË NORMËN E INTERESIT

Kujtim Gjevori, pronar i kompanisë “Scampa”, më tutje tregon se nga fillimi, por edhe tash, as-

njëherë nuk i ka bërë përshtypje norma e interesit në kredi. Sipas tij, më e nevojshme ka qenë sigurimi i mjeteve financiare në kohën kur atij i janë dashur, se sa shuma e mjeteve që më pas ai ka paguar në emër të normës së interesit.

“Kur e kam marrë kredinë e parë ndoshta norma e interesit ka qenë mbi 20 për qind, e tash kjo e fundit është 5 %, por të them me shumë sinqeritet që asnjëherë se kam shikuar këtë detaj. Asnjëherë s’ka pasur rëndësi kamata për mua. Për mua ka qenë me rëndësi partneriteti, e kur më janë dashur paratë i kam marrë dhe me to unë në vazhdimësi e kam zhvilluar biznesin tim”, tregon ai.

ZHVILLIMI PËR MË PAK SE DY DEKADA

Gjevori tregon se si kishte vendosur të merret me biznes, menjëherë pas përfundimit të luftës në vend në vitin 1999. Ai në atë kohë një periudhë të shkurtër kishte punuar si përkthyes në misionin e UNMIK-ut në Kosovë. Por, në fund të vitit 1999, e kishte lënë punën dhe kishte hapur një biznes të vogël për shpërndarje të pijeve, por, sot pas gati dy dekada në kompaninë e tij ka arritur të punësoj rreth 50 punëtorë, e në vitet në vijim ai planifikon që numrin e punëtorëve të rrisë edhe më shumë. “Unë e kam nisur biznesin në vitin 1999 me rrogën e fundit që e kam marrë në atë kohë si përkthyes në











90%

të tregut kosovar me qese të plastikës mbulohet nga bizneset vendore, pjesa tjetër importohet.

UNMIK. Pas një kohë të shkurtë, më është dashur ndihmë financiare, familja nuk ka pasur mundësi, dhe në atë kohë unë kam marrë një kredi 9,000 euro për zhvillim të biznesit, por, që nga ajo kohë e deri më tash për mua partneri kryesor në biznes ka qenë banka”, thotë biznesmeni Gjevori. Ai më tutje tregon se në vitin 2002 kishte arritur ta blinte një makinë industriale për paketim të sheqerit, ku gjatë kohës është përballur me sfida të shumta. “Hyra në prodhim pa dije dhe pa eksperiencë. Një kohë e kam pasur shumë të vështirë sa që kam fjetur edhe mbi paleta të sheqerit. Asokohe u detyrova ta marrë një kredi prej 30 mijë eurosh. Kisha telashe financiare, por asnjëherë nuk jam vonuar në shlyerjen e ratave të kredisë, pasi që në atë kohë bankën e kam konsideruar partnerin tim kryesor”, tregon më tutje ai.

Sektori financiar dhe i patundshmërive, atraktiv për investitorët

Investimet në
miliona euro
ndër vite

	2007	2008	2009	2010
 BUJQËSI	7.9	8.5	13.1	0.9
 MINERALE	41.5	17.4	7.0	17.7
 INDUSTRI	74.8	53.7	57.6	101.1
 ENERGJETIKË	2.5	16.7	8.7	/
 NDËRTIM	52	13.5	35.5	54.2
 SHËRBIME TREGTARE	12.7	10.1	16.2	6.8
 HOTELE DHE RESTORANTE	12.7	2.1	2.4	/
 TRANSPORT DHE KOMUNIKIM	129.2	51.0	21.9	-15.9
 SHËRBIME FINANCIARE	102.0	109.6	75.3	39.4
 PATUNDSHMËRI. QIRADHËNIE	30.9	62.9	43.9	75.5

Sektori i patundshmërive edhe ai financiar edhe më tutje vazhdojnë të jenë ndër sektorët vendorë më joshës për investitorët e huaj. Bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se gjatë vitit 2017 në sektorin e patundshmërisë janë investuar 187.2 milionë euro. Nga fillimi i këtij viti e deri në fund të muajit gusht në këtë sektor investitorët e huaj kanë investuar 117,3 milionë euro. Po ashtu, sipas të dhënave zyrtare edhe sektori i shërbimeve financiare po tregohet tërheqës për investitorët e huaj. Konstatime të tilla mund të mbështeten në faktin se gjatë vitit që lamë pas, në këtë sektor investitorët e huaj kanë investuar

hiç më pak se 55 milionë euro, derisa gjatë periudhës raportuese janar-gusht 2018 janë investuar 1,8 milion euro. Gjithnjë duke u bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës, shihet se nga fillimi i vitit 2018 e deri në fund të muajit gusht në sektorin e bujqësisë janë investuar 200 mijë euro, derisa gjatë vitit që lamë pas ka pasur tërheqje të investimeve nga ky sektor. Po sipas këtyre të dhënave, edhe në sektorin energjetik gjatë 8 muajve të parë të këtij viti investitorët e huaj kanë investuar 2,9 milionë euro, derisa në sektorin e industrisë dhe atë të mineraleve ka tërheqje të investimeve të huaja.

2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
0.6	0.3	0.4	0.2	1.0	1.2	-1.3	0.2
-5.2	-25.0	-14.1	4.2	-36.9	-19.1	-4.9	-6.9
46.9	27.4	11.5	-34.0	20.7	4.6	5.7	-17.3
0.2	2.2	48.8	13.4	11.9	3.4	-1.0	2.9
133.1	31.1	17.3	-19.9	46.3	28.2	5.0	-14.7
11.6	9.3	14.6	8.4	12.0	14.5	10.3	15.7
0.2	0.5	0.8	0.4	0.0	0.7	0.8	1.5
29.0	32.4	51.0	-9.1	-6.1	-9.1	-7.9	-4.4
33.0	22.4	4.4	41.9	64.3	19.00	55.0	1.8
60.5	115.7	136.1	142.1	189.6	167.2	187.2	117.3



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

The voice of banking in Kosovo

Shoqata e Bankave të Kosovës reagon ndaj grabitjeve të bankave

Gjatë vitit 2018, sektori bankar në Kosovë është ballafaquar me një numër të paprecedent të rasteve të sulmeve fizike ku shumica prej tyre ishin grabitje të kryera nga grupe të rrezikshme kriminale të armatosura me armë të gjata. Derisa dëmet materiale ishin të larta, Shoqata e Bankave të Kosovës ka shprehur shqetësimin më të madh për sigurinë e klientëve dhe stafit të bankave.

Sipas një njoftimi për medie nga Shoqata e Bankave të Kosovës, sektori bankar punëson rreth 3500 punëtor dhe shërben mijëra klientë për çdo ditë duke ofruar kështu shërbime financiare shumë të rëndësishme për ekonominë e Kosovës, prandaj për bankat është prioritet

kryesorë që klientët e tyre të ndihen rehat dhe të sigurte në marrjen e shërbimeve në banka, si dhe që punonjësit e bankave të kryejnë punën e tyre në një mjedis të sigurte.

‘Në disa nga këto sulme, punonjësit e bankave janë lënduar dhe është dashur të pranojnë trajtim mjekësorë pasi që këto grupe mafioze janë zakonisht shumë të rrezikshëm dhe të dhunshëm në sulmet e tyre. Për më shumë, këto grabitje i fuqizojnë këta kriminel që të përdorin paranë e vjedhur për të blerë në mënyrë të jashtëligjshme armë, drogë dhe të kryejnë shumë krime tjera brenda Kosovës dhe në rajon, duke rezultuar në gupe të organizuara kriminale gjithnjë e më të fuqishme, gjë

që paraqet kërcënim për sigurinë nacionale të vendit’, thuhet mes tjerash në njoftimin e Shoqatës.

Bazuar në statistikat e ofruara nga Policia e Kosovës është e evidente që edhe bizneset tjera në Kosovë janë duke u ballafaquar me sulme në baza të rregullta dhe i nënshtrohen rreziqeve dhe kërcënimeve të tilla. Prandaj, Shoqata e Bankave të Kosovës i bënë thirrje institucioneve të sigurisë në Kosovë të ndërmarrin masa urgjente dhe të fuqishme kundër këtyre grupeve kriminale për të shpartalluar ato dhe për të siguruar mjedis të sigurte për bizneset e Kosovës, duke i dhënë vëmendje të veçantë institucioneve financiare

BQK nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi me Bankën Qendrore Evropiane

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me Bankën Qendrore Evropiane (BQE).

Me këtë rast guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, ka shprehur kënaqësinë për nënshkrimin e këtij memorandumi, i cili është i një rëndësie të madhe për BQK-në dhe Kosovën.

“Ky memorandum, përveç tjerash ka për qëllim thellimin e marrëdhënieve mes dy institucioneve rregulluese të sistemit bankar, rritjen e bashkëpunimit me qëllim të shkëmbimit të informacioneve, bashkëpunimin lidhur me mbikëqyrjen në vend, të ekzaminimeve dhe çështje tjera. Memorandumi me BQE-në, forcon edhe më shumë lidhjen mes Kosovës dhe Bashkimit

Evropian, ndërsa neve si BQK do të na ndihmojë shumë që të ecim përpara me përmbushjen e të gjitha detyrimeve, që dalin nga integritet evropiane”, ka deklaruar guvernatori Mehmeti.

Dy palët nënshkruese janë pajtuar që të rritin shkëmbimin e njohurive dhe ekspertizës, pastaj këshillat teknike, trajnimet, seminarët, etj.



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Kjo shtojcë mbështetet nga Shoqata e Bankave të Kosovës